# Kriteret e Pranimit të Studentëve në FASTIP

## Viti akademik 2018-2019

Për të githë maturantët që janë duke menduar për studimet e tyre, Universiteti “Aleksandër Moisiu” në Durrës ofron mundësitë më të mira për ndjekjen e studimeve të larta me programet e studimit të gjashtë fakulteteve. Ndër to edhe Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP).

Çdo maturanti që ka shlyer detyrimet e shkollës së mesme dhe e ka përfunduar atë me mesataren mbi 6(gjashtë), i lind e drejta për të aplikuar e për të përzgjedhur FASTIP me programet e studimit Bachelor në:

1. Menaxhim i Bankave
(Program në gjuhën angleze)

**Banka partnere:**

BANKA KOMBETARE TREGTARE

2. Menaxhim i Hoteleri-Turizëm

(Program në gjuhën angleze)

**Partner:**

HARMONIA
HOTELS GROUP

3. Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme

(Program në gjuhën angleze)

**Partner:**

**Kriteret e pranimi janë:**

- Nota e provimit të Anglishtes në provimin e Maturës Shtetërore të jetë mbi 6(gjashtë);

- Konkursi i pranimit (Testim me shkrim në gjuhën Angleze+intervistë punësimi).

## **Avantazhet e të studiuarit në FASTIP:**

Partneriteti publik-privat merr jetë në formën më të mirë e më profesionale pikërisht në FASTIP.

- FASTIP u ofron studentëve studime duale me pedagogë ndërkombëtarë.

- Sipërmarrjet private (kompanitë) që përgjedhin studentët e ardhshëm të FASTIP nëpërmjet konkursit të pranimit, u ofrojnë mundësinë për ta vënë në praktikë dijen akademike të marrë në auditoret e Fakultetit, duke i trajnuar në çdo proces pune brenda kompanisë.

- FASTIP u ofron studentëve arsimim në gjuhën angleze (gjuhë e tregut të punës) me module dy/ tre javore. Në fund të studimeve Bachelor studentët marrin diplomën dy-gjuhëshe (shqip-anglisht), lëshuar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës.

- Kompania e cila u ka ofrour trajnimin profesional për tre vite me rradhë, në fund të tre-vjeçarit pajis studentët me kontratën e punës të garantuar.

- Raporti teori-praktikë është 50:50 (tre muaj trajnim profesional në kompani/tre muaj mësim në FASTIP) gjatë gjithë ciklit 3-vjeçar të studimeve.

Sepse, një student i FASTIP është në të njëjtën kohë edhe student edhe i punësuar që në ditën e parë të fillimit të studimeve.

**#UAMD#FASTIP**




Aktualisht, studente e vitit të tretë në programin e studimit “Menaxhim i Bankave”. Trajnimim profesional e kryen pranë Bankës Kombëtare Tregtare, partnerit strategjik të FASTIP.




Studente e programit të studimit “Menaxhim i Hoteleri-Turizëm” gjatë trajnimit profesional në ambjentet e Albanian Star (AS)-Hotel të Harmonia Hotels-Group.

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës
Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)
www.fastip.edu.al




Studentë të diplomuar në tetor 2017, në programin e studimit “Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme”, të trajnuar në kompaninë më të madhe të telefonisë celulare në vend, VODAFONE Albania.

***Suksese!***

***Adresa: Lagjja nr.17, Rruga “Adria” (pranë Urës së Dajlanit), 2001, Durrës, Shqipëri***
***Tel./Fax. +355 52 224401***
***info@fastip.edu.al***
***fastip.edu.al***